

AFËRDITA ABDULLAHI

FUSHAT LEKSIKORE ME EMËRTIME PËR KAFSHË DHE BIMË NË ZONËN E KOSOVËS PERËNDIMORE DHE JUGPERËNDIMORE

Mjedisi gjeografik i Kosovës Perëndimore dhe Jugperëndimore karakterizohet me kodra, lugina, livadhe, etj. Ky mjedis është i mbuluar nga një bimësi e shumëllojtë dhe është shumë i përshtatshëm për rritjen e kafshëve.

Banori vendës i këtyre trojeve ka krijuar në rrjedhë të shekujve mjaft emërtime për vende dhe kafshë, të cilat janë motivuar nga tiparet karakteristike apo që i dallojnë ato. “*Rrugëtimi përgjatë historisë mund të pasqyrohet mirë përmes gjuhës, për t’i plotësuar nevojat gjuhësore, tradita e hershme blegtorale e kësaj ane ka ndikuar në krijimin e kushteve për formimin e fjalëve dhe kuptimeve të reja. Mbi këtë nevojë gjuhësore që ka prodhuar koha, janë formuar radhë fjalësh duke u bazuar në elemente të ndryshme, si: forma, koha, ngjyra, përbërja, vendi, konfiguracioni etj*”.¹

Së pari, në këtë punim shumë të shkurtër, po ndalemi për emërtimin e kafshëve që mbarështohen në shtëpi ose që njihen ndryshe me emërtimin *kafshë të buta*. Emërtimi i këtyre kafshëve është bërë zakonisht nga barinjte të cilët kujdeseshin për to, por edhe nga pjesëtarë të tjerë të familjes së këtyre barinjve. Emërtimet e kafshëve ngjasojnë me emërtimet e përveçme të njerëzve, sepse ato janë bërë dhe bëhen për t’i dalluar kafshët nga njëra-tjetra, por edhe nga kafshët tjera të fshatit.

Emërtime të shumta kemi për dhentë e për buallicat, kafshë këto që rriten shumë në Kosovë. Emërtimet e tyre përgjithësisht motivohen nga ngjyra e trupit. Por nuk janë të pakta edhe emërtimet për *dhitë*. Ato janë të kafshë shumë të lëvizshme dhe shumë të shkathëta. Dhitë, duke u ushqyer me shkurre etj., shpërndahen shumë në kullotë, ndaj edhe bariu kërkonte / kërkon që secila nga dhitë të ketë emrin e vet, që ai ta thërrasë, ta trembë, ta ndjellë për ushqim etj.

Në vazhdimësi po japim një listë të shkurtër të emërtimeve që kemi mbledhur, duke i dhënë jo sipas fushave tematike që lidhen me njërin apo tjetrin kafshë, apo me njërin apo tjetrin tregues që ka shërbyer për lindjen e emërtimit, por sipas rendit alfabetik:

bacan = dash me turinj të bardhë,

bacan = dele a dash me turinj të bardhë,

balec = çap me një njollë në ballë

balicë = dhi me një njollë në ballë

balosh = ka me një njollë në ballë

balushë = dhi me një njollë në ballë

¹ N. Berisha, *Leksiku dhe frazeologjia në fshatrat e Gjakovës*, Prishtinë, 2013, f. 9.

- ballica* = *buallicë*
bardh = ka i bardhë
bardhanë, lopë e bardhë
bardhec = kalë me ngjyrë të bardhë,
bardhoj = dash i bardhë
bardhoj = ka i bardhë,
bardhojë lopë e bardhë
bardhojkë = dash/dele i bardhë,
bardhokan = dash i bardhë
bardhue = dhi e bardhë,
bishtukë = lopë me bisht të bardhë,
brihapta = kafshë me brirë të larguar,
bull = buall
bullica = për lopën apo delen që është e trashë në trup,
cerr = pëllumb i ri, me pupla të reja,
cicvogla = kafshë sisë vogël,
cub = qen bishtshkurtër,
curë = dele veshvogël,
çafgati/a, = lopa apo mëzati që e ka qafën e gjatë, pastaj kemi,
ejë = dele a dhi që i ka ngordhur qengji,
galicë = dhi e zezë,
gaxhele = lopë me brirë të shtrembër.
grykëllarmë = shpend me pupla me ngjyra te gryka,
gushakuq = zog me gushën me pupla të kuqe.
kamërr = dhi me qime karakteristike në këmbë,
katicë = dhi e kuqe,
kinxh = vogli i deles, qengj
kishk = i vogli i baullivës,
kishki = e vogla e buallicës
krru:ta, krrulejka = për lopën që e ka formën e trupit të kthyer, ose edhe brirët e kthyer;
kuqoj = ka i kuq,
laraskë = shpendi zi me njolla të bardha, shpend i larmë
macqë = lopë, dele a dhi sisëprishur,
mangushë = lopë që ka mangët një sisë, lopë me tri sisa,
maz = i vogli i pelës
murrakë = lopë e murrme,
murricë = lopë e murrme
murroj = ka i murrmë,
murroj = lopë e murrme,
mzat, = dem
rogush = dele me brirë si të dashit,
rudë = dele leshbutë,
sugaricë = dele që rrit sugarin,

Fushat leksikore me emërtime për kafshë dhe bimë në zonën e Kosovës...

sharan = dash i larmë,
shkurtëz = shpend që e ka bishtin më të shkurtër se trupin,
shqeplugë = shqepi në formë të lugës,
shytë = ka pa brirë,
trashukë = lopë a dele e trashë,
vigël = dele trupvogël, trupshkurtër,
xhicakulle = dele me gjinj të mëdhenj,
xhufkë = shpend maja e kokës si xhufkë, shkurtë,
zhurme (e) dele që përreth syve ka ngjyrë kafeje të çelët
zhutan = dash që përreth syve ka ngjyrë kafeje të çelët,

Studiuesi V. Memisha thekson se “Është mjaft interesant fakti se në të folmet popullore, në gjuhën shqipe emërtimet e kafshëve përdoren me ngjyrim emocionues edhe për njerëzit, në disa raste në aspekt pozitiv, dhe në disa raste në aspekt negativ. Po ndodh një çudi: emërtimet e kafshëve të buta përdoren me ngjyrim emocionues negativ (kur kafshët janë të dobishme), kurse emërtimet e kafshëve të egra përdoren me ngjyrim emocionues pozitiv, një dukuri etnolinguistike e etnokulturore për t’u studiuar më tej.”²

Zakonisht në këto të folme emërtime të tilla dalin për të përqeshur, për të tallur, por nuk mungojnë edhe përdorimet me kuptim vlerësues si lavdërim, përkëdhelje, mburrje etj.

galan ose galicë u thuhet meshkujve/femrave që janë me flokë të zinj;
zhut u thuhet njerëzve me qime të kuqe;

krrutan ose krrutejk atyre që janë më të gjatë me trup të cilët rrinë si të përkulur

shotan që janë të ngadalshëm ose që nuk mendojnë shumë “*e pash t’u ardh, ecke si shotan*”;

magar atyre që punojnë më shumë se që paguhen në aspekt ironik, pasi që gomari cilësohet si kafshë që ka bartur shumë gjëra edhe pse nga pesha është më i dobët,

zagar fëmijëve zakonisht që kalojnë më shumë kohë duke lozur, që rrinë jashtë shtëpisë,

arushan atyre që tregojnë forcën e arushës,

dhi nga mendja, atyre që ju ka ikur mendja etj.

Së dyti, trojet tona njihen edhe për emërtimet për tokën, për arat, për bimët bujqësore, sidomos për drithërat etj., që janë kultivuar dhe kultivohen nga shqiptarët. Emërtimeve që lidhen me bimët bujqësore janë mjaft e hershme. Vilma Proko-Jazexhiu, në punimin monografik për leksikon terminologjik të agronomisë në gjuhën shqipe thekson se “Një bujqësi të lëvruar qysh herët, një bujqësi me lërim, një inventar të plotë e të larmishëm veglash bujqësore dhe bujq e blegtorë me përvojë kishte në Ilirinë e Jugut në shek. IV e sidomos në shek. III p.e.s. Në

² V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011, f. 47.

burimet antike të shkruara nuk kumtohet asgjëkund që ilirët të kenë blerë gurë nga të tjerët.”³

Në Kosovën Perëndimore dhe Jugperëndimore përdoren gjerësisht fjalët e mbarë shqipes *misër* dhe *grurë*. Por në këto treva është përdorur dhe përdoret më shumë emërtimi *kallamboq*.

Në këtë areal gjeografiko-gjuhësor përdoren edhe shumë emërtime që kanë hyrë si orientalizma (nga turqishtja ose përmes turqishtes), si *zarzavate* (bimë a pjesë bimësh, që hahen si gjellë ose si sallatë, të ziera e të paziera, barishte, perime, lakurina, njomshtina), *bostan* (vend i mbjellë me pjepra e shalqi, vetë fryti i tyre: *Dy bostana s’mbahen në një dorë*), *duhan* (bimë industriale, me gjethe që përmbajnë nikotinë, që tymosen e pihen të thara: *Për duhan syri më qan, për raki vetë e di*), *hurme* (dru frutor, me origjinë nga vendet arabe, që bën kokrra të ngrënshme e të shijshme. Përdoret edhe si emër i përveçëm: *Dil, moj Hurma, dil moj bij*) etj.⁴

Në mesin e orientalizmeve që janë futur tashmë në gjuhën shqipe e që përdoren dhe në Kosovën Perëndimore dhe Jugperëndimore, përmendim fjalë, si: *bahçe, kajsi, majdanoz, manushaqe, portokall, pelin, tatull, fistik, kafe, selvi* etj.

Rrafshi i Dukagjinit ka emërtime të shumta sa i përket bimësisë. Arsyeja kryesore është se ky areal ka pozitë mjaft të mirë gjeografike, ka toka shumë të mira pjellore, që bëjnë të kultivohen shumë bimë, ashtu si ka male, kodra etj. ku rritet një florë me lloje të ndryshme bimësh.

Në këto treva janë të përhapura të gjitha llojet e barishteve dhe të perimeve. Relievi i ndryshueshëm, përbërja e tokës, klima dhe pasuria me ujëra, kanë ndikuar në zhvillimin e botës bimore. Në këtë zonë kemi emërtime të tilla për bimë: *rrobulli, arneni, pisha e bardhë, pisha e zezë* dhe *selvia*. Në vendet bregore dhe me lagështi është i përhapur *ahu* (në Kopaonik). Gjithashtu, rritet edhe *dellinja, ulza*. Në viset më të ulëta rritet lloje të *bagremit: mani i bardhë, mani i zi, rrapi, plepi kanadez, frashëri amerikan*, etj.

Në lartësitë 900-1500m, janë të përhapura bimësitë e përziera gjethembajtëse: *bredhi i kuq, bredhi (çami), boriga (pisha e zezë), çatina* etj.

Nën ndikimin e klimës mesatare (që depërton) nga Shqipëria, rrite edhe *gështenja*. Po ashtu në këto treva gjën dhe *boronica*.

Edhe emërtimet për bimësinë në këto troje kanë lindur në bazë të ndonjë karakteristike të veçantë, në bazë të formës, të ngjyrës etj.:

- *lu:l shqiponje* = fletët e saj janë të ngjashme me shqiponjën dykrenore;
- *dardha Hasi, molla Hasi, rrushi i Cermjënit, specia Dobroshti* etj.⁵
- *lu:l kompiri (patateje)* = emërtimi ka në bazë rrënjët në formën e patates (kompirit);
- *lule shpata* = forma e gjetheve të kësaj luleje është e ngjashme me shpatën.

³ S. Anamali, *Arkeologjia dhe bujqësia*, Tiranë, 1980, f. 47.

⁴ T. N. Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*, AIITC, Tiranë.

⁵ N. Berisha, *Leksiku dhe frazeologjia në fshatrat e Gjakovës*, Prishtinë, 2013, f. 16.

Fushat leksikore me emërtime për kafshë dhe bimë në zonën e Kosovës...

- **mo:ll rrokaqe** = e ka marrë emrin nga zhurma që bëjnë farat e kësaj molle kur e lëvizim;
- **mo:ll gjyle** = mollë në formë të rrumbullakët;
- **da:rdh longçe** = dardhë, që kur piqet, është shumë e lëngshme;
- **mo:ll sherbete** = lloj molle shumë e ëmbël;
- **kumbulla shiqere** = lloj shumë i ëmbël kumbulle dhe që përdoret për reçel;
- **mokth** = bar me erë të rëndë, i cili rritet në gjatësi deri më 50 cm, ka gjethe të vogla dhe me majë të mprehtë;
- **kalbasht** = dru i thatë dhe i kalbur ku zhvillohen kërpudhat;
- **lidhoj** = lloj bime që u ngjitet drunjve.

Edhe emërtimet me në bazë ngjyrën e **verdhë** na dalin shumë interesante. Ngjyra e verdhë në leksikon e Gjakovës ka dy gjegjëse, në qytet i thuhet "**e sarit**", kurse në fshatra i thuhet "**e luls**". Emërtimin e përdorur në qytet "**i/e sarit**" (sipas fjalorit të Tahir Dizdarit është fjalë e burimit oriental⁶) e gjejmë të përdorur edhe në shumë pjesë tjera të folmeve geqe.

Emërtimin "**i / e luls**", të përdorur në katunde, nuk e gjejmë në të folmet e tjera të gegërishtes. *Ish ba livadhi luls prej lulave* (Livadhi qenka verdhuar me shumë lule).⁷

Si përfundim, të folmet e Kosovës Perëndimore dhe jugperëndimore, në përgjithësi janë shumë të pasura me emërtime të ndryshme për kafshë e bimësi. Ato gjenden në gojën e popullit. Ato duhen mbledhur dhe duhen studiuar, duke parë dhe mundësinë që të futën në standard, në bazë të vlerave shënuese që ato mbartin.

⁶ T. Dizdari, *Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe*.

⁷ N. Berisha, *Leksiku dhe frazeologjia në fshatrat e Gjakovës*, Prishtinë, 2013.

